



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:233055

Datë: 09.10.2023

Numri i dokumentit: 04767207

C.nr.1640/2008

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, duke shqyrtuar dhe zgjidhur kontestin nga marrëdhënia juridike civile sipas padisë së paditësit B. P., nga Prishtina, përfaqësuar me autorizim nga Sh. A., jurist, dhe E. I., avokate në Prishtinë, kundër të paditurve QKM R. sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe R. I., nga Prishtina, që të dy përfaqësuar me autorizim nga S. M., avokat në Prishtinë, me objekt të kontestit kthimi i huas, me vlerë të objektit të kontestit në shumën prej 250,000.00€ (dyqindpesëdhjetë mijë euro), pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të çështjes, të mbajtur më datë 06.09.2023, në seancë publike, në prezencën e të autorizuarve të paditësit, të paditurit R. I., dhe të autorizuarve të paditurve, më datë 21.09.2023, dha këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e themeltë kërkesëpadia e paditësit B. P., nga Prishtina, dhe DETYROHEN të paditurit QKM R. sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe R. I., nga Prishtina, që paditësit në mënyrë solidare t'ia kthejnë shumën e të hollave prej 250,000.00€ (dyqindpesëdhjetë mijë euro), me kamatë në lartësi si të cilën e paguajnë bankat në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga 04.09.2008 deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuari të tij me datën 04.09.2008 ka parashtruar padi në këtë gjykatë me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurit QMK “ R” sh.p.k me seli në Prishtinë, dhe R. I. nga Prishtina, që paditësit në emër të kthimit të huas në mënyrë solidare t’ia kompensojnë shumën prej 250,000.00€ (dyqind e pesëdhjetë mijë euro).

Gjate seancave, plotësimit- precizimit të padisë të datës 24.05.2023, shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim me datën 20.09.2023 të autorizuari e paditësit kane deklaruar se qëndrojnë në tërësi pranë padisë edhe kërkesës së saj, duke theksuar se paditësi dhe i paditurit R. I. kishin lidhur kontrate mbi huan me datën 20.04.2006, dhe e njëjta kontrate ishte lexuar dhe nënshkruar nga të dyja palët, në të cilën i kane specifikuar edhe kushtet e kthimit të huas. Paditësi me datën 24.04.2006 në llogarinë e QMK “ R” kishte transferuar shumën prej 250,000.00€ (dyqind e pesëdhjetë mijë euro), tutje ka theksuar se kontratën e huas paditësi kishte marr për sipër huazimin e mjeteve financiare në vlerën prej 250,000.00€ (dyqind e pesëdhjetë mijë euro), për të mirën e të paditurve pa ndonjë destinim të specifikuar dhe ashtu siç është shënuar në atë kontratë, paditësi i ka bartur mjetet financiare në llogarinë e QMK “ R”.

Me tej ka theksuar se paditësi disa here kishte tentuar që ti kërkoj mjetet e huazuara nga i paditurit R. I., mirëpo asnjëherë nuk kishte marr përgjigje, me që i padituri R. I. pas me shumës së 12 muajsh nuk i kishin kthyer mjetet e huazuara, atëherë paditësit përmes një e-maili të datës 22.05.2007 ka kërkuar që ti kthehet shuma e huazuar, mirëpo asnjëherë nuk kishte marre përgjigje pozitive nga i padituri R. I. Si përfundim ka theksuar se, faktet e përmendura më sipër janë të mbështetura me prova materiale të pamohueshme dhe të konfirmuara nga vetë i Padituri, se me vullnetin e tij të plotë ka nënshkruar Kontratën e Huas dhe me mjetet e tilla supozohet se ka blerë shtëpi dhe asnjëherë deri më tani nuk ia ka kthyer mjetet e tilla Paditësit qoftë në para apo në të mira në natyrë.

Tutje, të vetëdijshëm për mungesën e themelësisë së pretendimeve të veta, të Paditurit vazhdimisht kanë tentuar që të shtrembërojnë faktet e rastit me shpresën se ndonjëra nga pretendimet e tyre do të pranohet si e mirëqenë nga gjykata. Përkatesisht, në Përgjigjen në Padi, të datës 16 prill 2009, i Padituri me besimin se nëse e mohon

ekzistimin e Marrëveshjes së Huas nuk do të detyrohet t'i kthej mjetet e huazuara, ka theksuar se Marrëveshja e Huazimit është fiktive. Ngjashëm, në seancën gjyqësore, të mbajtur më 11 maj 2023, përfaqësuesi i autorizuar i Paditurit ka deklaruar se Marrëveshja e Huas është nënshkruar vetëm nga njëra palë. Pretendimi se Marrëveshja e Huazimit është fiktive dhe e nënshkruar vetëm nga njëra palë janë përgënjeshtuar nga vetë i Padituri në seancën gjyqësore të datës 6 shtator 2023, në të cilën seancë i Padituri ka konfirmuar se ai ka lexuar dhe ka nënshkruar Marrëveshjen e Huazimit dhe mbi bazën e kësaj të fundit ka pranuar huan në vlerë prej 250,000.00 (dyqind e pesëdhjetë mijë euro) të cilën nuk e ka kthyer ende. Duke kuptuar se mohimi i autenticitetit të Marrëveshjes së Huazimit mund të verifikohet në çdo kohë, të Paditurit kanë deklaruar se huaja në shumë prej 250,000.00 (dyqind e pesëdhjetë mijë euro) i është dhënë për të blerë një shtëpi në afërsi të Gërmisë për të ndërtuar një spital. Edhe ky pretendim është tërësisht i pambështetur. Kjo pasi që, mjetet e huazuar sipas Marrëveshjes së Huas nuk janë huazuar më një destinim të caktuar por vetëm mbi bazën e kërkesës së Paditurit dhe gjendjes së tij të vështirë financiare në atë kohë.

Me tej të njëjtit kanë theksuar se saj përket pretendimeve të palëve të paditura lidhur me kompetencën e Gjykatës Themelore në Prishtinë duhet të theksohet se vullneti i palëve duhet të respektohet nga gjykata , mirëpo kompetenca e Gjykatës është prapësuar nga i padituri në vitin 2023 ndërsa përgjigja në padi është paraqitur pranë gjykatës më 16.04.2009. Përveç të larte cekurave të autorizuarit e paditësit kanë deklaruar se i kundërshtojnë r pretendimet e palëve të paditura në lidhje me çështjen e parashkrimit të kërkesës. Tutje kane theksuar se paditësit me të paditurin R. I. ka hy në marrëdhënie kontraktuale me nënshkrimin e marrëveshjes së huazimi, qëllimi i kontratës ka qen huazimi e jo dhurimi, dhe në kontratën e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurit decidivisht është cekur se shuma e huazuar duhet ti kthehet paditësit po sa ketë ta kërkoj paditësi që do të thotë në lidhje me afatin e kthimit të huas në kontratën e huas nuk është përcaktuar koha e kthimit të huas.

Tutje të autorizuarit e paditësit kane pretenduar se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se palët ndërgjegjëse kane lidhur me vullnetin e plote marrëveshjen e huas, paditësi i ka transferuar mjetet prej 250,000.00 (dyqind e pesëdhjetë mijë euro), i padituri

nuk i ka kthyer asnjëherë paditësit huan, paditësi nuk ka pasur asnjë përfitim çfarë do qofte nga huazimi i mjeteve dhe se i padituri R. I. asnjëherë nuk ka iniciuar asnjë procedure ligjore për të kontestuar vërtetësinë e marrëveshjes së huas. Mbi bazën e kësaj siç u tha me lartë, të njëjtit kane kërkuar që gjykata të merr aktgjykim me të cilin do të aprovohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit B. P.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurve gjatë seancave, parashtrësive të dorëzuar në gjykatë, shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim me datën 20.09.2023 ka deklaruar se qëndrojmë në tërësi pranë parashtrësive të dorëzuara, deklarimeve në seancat gjyqësore të mbajtura, pranë provave të dorëzuara në gjykatë të cilat janë pjese e shkresave të lëndës dhe konsiderojmë se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes në rastin konkret në mbështetje të provave relevante në shkresat e lëndës është vërtetuar plotësisht se të gjitha kërkesat e paditësit të përfshira si në padi janë të pa bazuara. Ashtu që fillimisht ka theksuar se padia e paditësit është në tërësi e pa bazuar në prova dhe në ligj dhe ka për qëllim vetëm dëmtimin e imazhit të paditurit, e kjo është vërtetuar gjatë gjithë procedurës gjyqësore.

Tutje ka theksuar se padia e paditësit B. P., nga Prishtina duhet të refuzohet nga Gjykata e shkallës së parë si e parakohshme pasi që paditësi asnjëherë nuk i ka kërkuar të paditurit të përmbush obligimin nga Kontrata e Huas e dt.20.05.2006 (ekzistimin e të cilës e kontestojmë), pra paditësi asnjëherë nuk ka dal para të paditurit dhe të kërkoj përmbushjen e kësaj kontrate por i njëjti direkt pa shterur asnjë mundësi apo mjet tjetër ka paraqitur padi. Kjo më së miri shihet edhe nga vet fakti se padia nuk ka të bashkangjitur as edhe një provë të vetme se të paditurit i janë kërkuar kthimi i të hollave sipas asaj kontrate, andaj kjo Gjykatë në rastin konkret duhet të mare parasysh nenin 319 të Ligjit të Procedurës Kontestimore i cili thotë: " Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta", e ku paditësi nuk ka paraqitur asnjë fakt me të cilin do të vërtetohej se i njëjti ka kërkuar përmbushjen e kontratës nga i padituri ndërsa i padituri ka refuzuar e sidomos kur merret parasysh që në

kontratën e prezantuar nuk ka asnjë afat në të cilën citohet se kur duhet të kthehet mjetet e huazuara ani pse kemi të bëjmë me një shumë të lartë.

Me tej ka theksuar se sipas Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve neni 572, par.2 theksohet: "Në qoftë se kontraktuesit nuk kanë caktuar afatin për kthimin e huas dhe as që ky mund të caktohet nga rrethanat e huas, huamarrësi ka për detyrë ta kthejë huan pasi të ketë kaluar afati i arsyeshëm, duke filluar që nga kërkesa e huadhënësit që huaja t'i kthehet e që nuk mund të jetë më i shkurtër se dy (2) muaj" dhe sipas Komentarit Zyrtar-Pjesa e Dytë' të këtij Ligji, në faqe 189 theksohet "Në rastet kur afati i kthimit të huas nuk është përcaktuar me kontratë dhe huadhënësi, pa parashtruar kërkesë për kthimin e huas ose para kalimit të afatit prej dy muajve nga dita e parashtrimit të kërkesës, paraqet padi në gjykatë për kthimin e huas, padia e paraqitur është e parakohshme" e që përputhet në tërësi me rastin konkret ku paditësi nuk ka paraqitur as edhe një kërkesë për kthimin e huas. Pra në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve si dhe provave të paraqitura në këtë procedurë padia e paditësit B. P. duhet të refuzohet si e parakohshme.

Tutje i njëjti ka theksuar se në këtë çështje civile paditësi si të paditur e ka paraqitur Universitetin e shkencave Mjekësore "R", e cila nuk ka legjitimitet pasi që kontrata për të cilën është paraqitur padia nuk është e lidhur në mes paditësit me të njëjtin por në mes të paditurit dhe R. I. i cili në këtë kontest paraqitet vetëm si ndërhyrës, andaj e njëjta në drejtim të Universitetin e shkencave Mjekësore "R " si i paditur duhet të refuzohet.

Me tej në lidhje me çështjen e potencuar edhe më herët nga Kontrata për të cilën është filluar kjo procedurë gjyqësore shihet mjaftë qartë se ekziston marrëveshja për kompetencën në rast të mosmarrëveshjeve në mes të palëve, e që nuk është kompetente Gjykata para të cilës paditësi ka filluar këtë procedurë. Pra në kontratë e lidhur me datën 20.04.2006 si vend për zgjedhjen e mosmarrëveshjes e kanë caktuar qytetin e Luganos, dhe si të drejtë që duhet të aplikohet mbi marrëdhënien kontraktore të tyre të drejtën zvicerane. Duke u nisur nga ligjet në fuqi të aplikueshme në Kosovë, Ligji për Procedurën Kontestimore neni 66, par.1 "Në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar kompetenca

territoriale ekskluzive e gjykatës për çështjen konkrete, palët mund të merren vesh që në shkallë të parë të gjykojë gjykata që nuk është me kompetencë territoriale, me kusht që kjo gjykatë të jetë me kompetencë lëndore." Shohim qartë se kompetente ka qenë Gjykata në shtetin tjetër e që është Zvicër e jo Gjykata Themelore në Prishtinë, e kjo kontratë përkatësisht kjo marrëveshje e nënshkruar i është bashkangjitur padisë nga vet paditësi por nuk është marrë parasysh.

Tutje i njëjti në lidhje me provat e administruara në shqyrtimit kryesore ka potencuar se shihet qartë se nuk ka asnjë provë të vetme me të cilën është vërtetuar se paditësi ka kërkuar kthimin e të hollave nga i padituri R., jashtë rrugëve gjyqësore por i njëjti direkt pa shterur mjetet tjera ka iniciuar padi. Nga Marrëveshja e Huazimit shihet se nuk ka as edhe një afat brenda të cilit është paraparë kthimi i këtyre të hollave, mirëpo kompetenca dhe se cili ligj do të jetë i zbatueshëm janë të përcaktuara nga kjo Marrëveshje.

Me tej nga deklarata e të paditurit R. I. në lidhje me provat siç janë: Marrëveshja e dt.20.08.2005, Marrëveshja e dt.27.12.2005, Marrëveshja e dt.23.12.2006, shihet qartë se paditësi me të paditurin kanë qenë në marrëdhënie afariste të ndërsjella, vazhdimisht kanë qenë në rolin e kreditorit dhe debitorit dhe anasjelltas, ashtu që këto marrëveshje pa dyshim vërtetojnë se parat e transferuara nuk kanë qenë huazim por kanë qenë para mbi realizimin e projekteve të tjera ku madje për paditësin është bërë kompensimi i këtyre të hollave me një hektarë tokë me qëllim të investimit të përbashkët.

Tutje i njëjti ka theksuar se nga dëshmia e paditësit e dhënë me datën 21.6.2023 vërehet qartë e njëjta nuk përputhet as me provat të cilat vet paditësi i ka dorëzuar, ashtu që i njëjti ani pse kanë qenë me të paditurin në marrëdhënie të shumta afariste i njëjti në këtë seancë thotë se marrëveshja për të cilin është filluar procesi kontestimor është e vetmja marrëveshje ndërmjet tyre edhe pse marrëveshjet tjera dhe email-at vërtetojnë tjetër nga ajo që paditësi ka deklaruar në seancë. Pra nga vet deklarata e të njëjtit vërehet qartë se ka tendenca për keqësimin e situatës së të paditurit duke deklaruar gjera të pavërteta të cilat madje bien në kundërshtim me vet deklaratën e tij nga faqja në faqe por edhe me provat e tjera dhe dëshminë e të paditurit.

Me tej ka potencuar se sa'i përket Marrëveshja e datës 20.08.2005, Marrëveshjes së datës 27.12.2005 të cilat përveç se vërtetojnë se të njëjtit kanë qenë gjatë tërë kohës në marrëdhënie afariste ndryshe nga që ka deklaruar paditësi se nuk kanë pasur marrëveshje tjetër, të njëjtat gjithashtu janë prova që janë bashkangjitur kundërpadisë të cilën i padituri e ka paraqitur ndaj paditësit, dhe e njëjta nga kjo Gjykatë është refuzuar duke u thirrur në inkompetencë mirëpo ani edhe pas parashtresës së dorëzuar që kjo padi ti dërgohet Gjykatës Kompetente (pasi që nga praktika por edhe sipas LPK-së në rast të refuzimit të padisë për shkak të kompetencës, kur kompetente është gjykata, i dërgohet lënda gjykatës që është kompetente) e njëjta nuk është hasur në mirëkuptim.

Se fundi i njëjti ka theksuar se nga të gjitha provat si dhe duke u bazuar në Ligjet në fuqi që janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës shihet qartë se padia e dorëzuar nga paditësi B. P. nuk është respektuar as e drejta materiale e as ajo procedurale, por e njëjta nuk është bazuar as në prova andaj si të tillë i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: vërtetimi për transferimin- pagesën i datës 24.04.2006, e datës 20.06.2007, urdhër pagesa e datës 11.04.2006, transferi intern i datës 20.06.2007, marrëveshja për huazim e datës 20.04.2006, korrespondencat përmes e-mailit, marrëveshja në mes r. dhe M. e datës 23.12.2006, marrëveshja e datës 27.12.2005, marrëveshja e datës 24.08.2005.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të theksuara më lartë në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), duke i çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata nga marrëveshja e huazimit e datës 20.04.2006 vërtetoi se paditësi B. P. me të paditurin R. I., kishin lidhur kontratë mbi huan, me vlerën e huas prej 250,000.00 (dyqind e pesëdhjetë mijë euro).

Gjykata nga vërtetimi për transferimin- pagesën i datës 24.04.2006, e datës 20.06.2007, urdhër pagesa e datës 11.04.2006 vërtetoi se nga llogaria bankare e paditësit ishin transferuar shuma e mjeteve sikur se në marrëveshjen e huas në lartësi prej 250,000.00 (dyqind e pesëdhjetë mijë euro), në llogarinë e të paditurës R. sh.p.k.

Gjykata me dëgjimin e paditësit B. P. në cilësi të palës, ka vërtetuar se paditësi i ka dhënë hua të paditurit R. I., shumen prej 250,000.00 (dyqind e pesëdhjetë mijë euro), ashtu sic është e përcaktuar dhe në kontratën e huas të datës 20.04.2006 lidhur mes të njëjtëve. Po ashtu i njëjti kishte deklaruar se parat e huazuara i kishte kërkuar disa here nga i paditurit, por i njëjti asnjëherë nuk ja kishte kthyer, dhe se për këtë arsye kishte filluar rrugët ligjore për realizimin e kërkesës së tije.

Gjykata në cilësi të palës e ka dëgjuar edhe të paditurin R. I., dhe nga deklaratimet e tije gjykata vërtetoi se i njëjti e kishte pranuar shumen e mjeteve prej 250,000.00 (dyqind e pesëdhjetë mijë euro) nga paditësi, të cilat sipas tije ishin destinim për projektin e ndërtimit të një spitalit në Gërmi, projekt i cili nuk ishte realizuar. Mirëpo parat nuk ja kishte kthyer asnjëherë paditësit.

Gjykata pasi vërtetoi këtë gjendje faktike dhe provat materiale, dhe me qene se në këtë çështje juridike, raporti juridik i detyrimit, është krijuar në vitin 2008, andaj edhe si ligj material është aplikuar Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 (referuar tutje si LMD e vitit 1978), ku neni 557 përcakton se „Me kontratën e huas obligohet huadhënësi t’ia dorëzojë në pronësi, respektivisht në deponim huamarrësit shumën e caktuar të hollash ose sasinë e caktuar të sendeve të tjera të zëvendësueshme, ndërsa huamarrësi obligohet ta kthejë pas një kohe të caktuar të njëjtën shumë të hollash, respektivisht të njëjtën sasi sendesh të llojit dhe të cilësisë së njëjtë”, lidhur me nenin 446 të LMD të vitit 1978 “Marrja përsipër e borxhit bëhet me kontratë midis debitorit dhe sipërmarrësit, për të cilën gjë ka dhënë pëlqimin kreditori. Mbi kontratën e lidhur

kreditorin mund ta njoftojë secili prej tyre dhe secilit prej tyre kreditori mund ti komunikojë pëlqimin e vet për marrjen përsipër të borxhit. Presumozohet se kreditori e ka dhënë pëlqimin e vet ne qoftë se pa rezervë ka pranuar ndonjë përmbushje nga sipërmarrësit, të cilën e ka bërë ky në emër të vet”.

Po ashtu në bazë të nenit 414 të LMD të vitit 1978 përcaktohet se “ Secili debitor i detyrimit solidar i përgjigje kreditorit për krejt detyrimin dhe kreditori mund të kërkojë përmbushjen e tij nga cilido që dëshiron gjithnjë gjersa të mos përmbushet tërësisht, por kur një debitor ta ketë përmbushur detyrimin ai pushon dhe të gjithë debitorët shkarkohen”.

Po ashtu sipas nenit 562, par. 1 i Ligji i Vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve lidhur me marrëveshjen e huas parasheh se Huamarrësi është i detyruar të kthejë brenda afati të përcaktuar, sasinë e njëjtë të objekteve të të njëjtit lloj dhe cilësi. Tutje paragrafi pasues parasheh se “Nëse palët negociuese nuk arrijnë të përcaktojnë kohën për kthimin e kredisë, ose nëse ajo është e pamundur të përcaktohet sipas rrethanave të huas, huamarrësi do të detyrohet ta kthejë huan pas skadimit të një periudhe kohore të arsyeshme, jo më të shkurtër se dy muaj, duke filluar nga kërkesa e huadhënësit që t'i kthehet huaja”. Duke qenë se tek Kontrata e Huas nuk parashihet ndonjë afat specifik për skadimin e kohës për realizimin e të drejtave me dhunë, në rastin konkret do të aplikohen rregullat e përgjithshme për parashkrimin prej 10 viteve të paraparë në Nenin 371 të Ligjit të Vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Mbi këtë bazë edhe pretendimi i të Paditurve për parashkrimin e kërkesës është i pa bazuar.

Si që pathemeltë, gjykata e refuzoi prapësimin e të paditurve lidhur me kompetencën territoriale të e gjykatës, sipas Ligji për Procedurën Kontestimore (i ndryshuar) neni 22 par. 1, shprehish mit përcaktohet se “ Gjykata mund të shpallet jokompetente në pikëpamje territoriale vetëm sipas prapësimit të palës së paditur të parashtruar përmes përgjigjes në padi”. Ndërsa nga shkresat e lendes konstatohet se përgjigja në padi nga i padituri është ber më 16.04.2009, ndërsa në vitin 2023 është prapësuar nga i autorizuari i të paditurit çështja e kompetencës territoriale.

Ndërsa lidhur me pretendimet për parashkrimin e kërkesës së paditësi gjykata vlerësoi se ky pretendim i të Paditurve se është i pathemeltë, sepse Marrëveshja e Huas është lidhur më 20 prill 2006. Në këtë kohë në fuqi ka qenë Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i ish Jugosllavisë (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/78, 39/85, 57/89), këtu e tutje referuar si "Ligji i Vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve." Aplikimi i Ligjit të Vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcaktohet nga Neni 1057 i Ligjit Aktual Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili shprehimisht parasheh se "dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji".

Gjykata nuk e ka lejuar parashtrimin e kundërpadisë së të paditurit R. I., me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri R. I. është titullar i të drejtës në pronës në objektin "F.", i cili gjendet në Prishtinë, prej 50%, dhe të obligohet paditësi që të paditurit në emër të fitimit të humbur t'ia paguaj 1,500,000.00€, pasi që në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për parashtrimin e kundërpadisë. Sipas nenit 256 par.1 të LPK, i padituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi derisa nuk ka përfunduar séance përgatitore, gjegjësisht seanca e parë për shqyrtimin kryesor, po që se seanca përgatitore nuk është mbajtur fare, në qofte së: a) kërkesa e kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë (kundërpadia kodekse); b) midis kërkesëpadisë dhe asaj të kundërpadisë mund të bëhet kompensimi (kundërpadia kompozues) c) me kundërpadi kërkohet vërtetimi i ndonjë të drejte apo raporti juridik nga ekzistimi apo mosekzistimi i të cilit varet tërësisht apo pjesërisht vendimi mbi kërkesën e paditësit (kundërpadia prejudiciale). Në rastin konkret, gjykata vlerëson se kërkesa nga kundër padia nuk ka lidhshmëri me kërkesën nga padia dhe se nuk mund të bëhet as kompensimi. Nga kjo del se kundërpadia është e palejueshme.

Gjykata, i vlerësoi edhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, mirëpo të njëjtat nuk patën ndikim tjetër në vendosën e çështjes.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 277 të LMD-ës.

Lidhur me piken II të këtij aktgjykimi që ka të beje me shpenzimet e procedurës

kontestimore gjykata vendosi në baze të nenit 463 par. 1 ku thuhet se “ Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën”.

Nga të gjitha të lartcekurave dhe konform dispozitave ligjore të sipër cekura dhe lidhur me nenin 142 dhe 143 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1640/2008 datë 21.09.2023

Gjyqtari

Përparim Zeka

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.